



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr.31. Datë.03/09/2025

***MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË LIDHJE ME INVESTIMET NË
BASHKËPUNIM ME BASHKITË E QARKUT***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 29, Ligjit Nr.9936 dt.25.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimin nr.9 dt.20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2025, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 51 date 23.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2025”, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

1. Të miratojë ndryshimet në buxhetin e vitit 2025, në lidhje me investimet e lëna në bashkëpunim me bashkitë, si më poshtë:

a) Pakësim fondi

Gr. 00 Tit. 06260 Kap. 05 Art. 230 6 000 000 lekë (Projekt preventiv zbatimi “Ndërtimi i Muzeut të Palafiteve dhe tharjes të kënetës të Maliqit”)

Shtesë fondi

Gr.00 Tit. 04130 Kap. 05 Art. 604 6 000 000 lekë (Kontribut për Bashkinë Maliq në lidhje me Projekt preventiv zbatimi “Ndërtimi i Muzeut të Palafiteve dhe tharjes të kënetës të Maliqit”)

b) Pakësim fondi

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 05 Art. 231 1 200 000 lekë (Pajisje për qendrën infopoint Ersekë)

Shtesë fondi

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 05 Art. 504 1 200 000 lekë (Kontribut Bashkia Kolonjë për Pajisje për qendrën infopoint Ersekë)

c) Pakësim fondi

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 01 Art. 231 14 722 118 lekë (Investime në bashkëpunim me bashkitë 60% me 40%)

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 05 Art. 231 8 000 000 lekë (Investime në bashkëpunim me bashkitë 60% me 40%)

Shtesë fondi

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 01 Art. 604 4 800 000 lekë (Kontribut Bashkia Pustec për blerje e një automjeti për pastrimin e liqenit dhe blerjen e një skafi 12 vendesh për transportin e

turistëve.)

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 01 Art. 604 215 760 lekë (Kontribut Bashkia Maliq për sinjalistikën orientuese dhe markimin e shtegut në liqenet Lenie-Valamarë)

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 01 Art. 604 2 706 358 lekë (Kontribut Bashkia Devoll për zhvillimin e turizmit dhe ruajtjen e ekosistemit të Liqenit të Prespës të Vogël)

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 01 Art. 604 7 000 000 lekë (Kontribut Bashkia Pogradec me destinacion "Sistemim i rrugës Rrëmenj-Gështenjas")

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 05 Art. 604 8 000 000 lekë (Kontribut Bashkia Maliq me destinacion "Rivitalizimi Rruga e Bacave Fshati Vlocisht")

2. Të autorizojë Kryetarin e Këshillit të Qarkut të nënshkruajë marrëveshjet e bashkëpunimit me bashkitë për kalimin e kontributeve sipas vlerave të preventivave të projekteve.
3. Disbursimi i kontributeve do të bëhet vetëm pas dorëzimit nga ana e Bashkive të projekt-propozimeve të cituara në pikën 1 të këtij vendimi, sipas vlerave të përlogaritura prej tyre.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Sektori i Financës financës dhe buxhetit, Sektori juridik, burimeve njerëzore dhe shërbimeve, Sektori i Projekteve të zhvillimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti.

KRYETARI

Erjon Nexhipi



Miratuar me 17 / Vota
Vota Pro 17 / Vota
Vota Kundër 0 / Vota
Vota Abstenim 0 / Vota
Zbardhur më datë 03/09/2025

Konceptoi: O. Beqiraj
Juristi: M. Bylykbashi
Sekretari: B. Mucic



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

***MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË LIDHJE ME INVESTIMET NË
BASHKËPUNIM ME BASHKITË E QARKUT***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 29, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2025”, Udhëzimin nr.9 dt.20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” Udhëzimeve të Ministrisë së Financave për zbatimin e buxhetit të vitit 2025, Vendimin e Këshillit të Qarkut nr. 51 date 23.12.2024 “Mbi miratimin e buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2025”, i paraqesim Këshillit të Qarkut disa ndryshime në lidhje me investimet në bashkëpunim me bashkitë.

Që në vitin 2024, Këshilli i Qarkut Korçë planifikoi në buxhet projekte investimesh që do të realizoheshin në bashkëpunim me bashkitë. Bashkëpunimi nga ana e bashkive konsistonte pikërisht në kalimin e kontributit të Bashkive, për llogari të Qarkut, sic e kanë edhe përcaktim ligjor pasi një nga burimet e financimit për Këshillin e Qarkut janë pikërisht kontributet e bashkive. Ky proces nuk ishte dhe aq i thjeshtë sepse kontributet nga ana e bashkive në vitin 2024 u derdhën shumë vonë. Problemi tjetër lidhej me dorëzimin e projekteve apo preventivave nga ana e bashkive. Duke qënë se Këshilli i Qarkut ka kapacitete të kufizuara në burime njerëzore, bashkitë duhet të ishin më bashkëpunuese për sa i përket kësaj pjese.

Kjo bëri që një pjesë e mirë e këtyre investimeve të mbeteshin pa u realizuar. Për të mos penguar realizimin e tyre edhe për këtë vit, Këshilli i Qarkut Korçë mendoi të bëjë kalimin e fondeve të lëna për këto investime në formë kontributi për Bashkitë, me destinacion të përcaktuar, në mënyrë që bashkitë ti realizojnë vetë projektet e planifikuara.

Të gjitha këto projekte të planifikuara në buxhet janë lënë sipas kërkesave të paraqitura nga ana e bashkive, edhe pse jo të gjitha janë të plotësuara me preventiva të plotë, dokumenta që do të plotësohen në momentin që do të bëhet kalimi i fondeve.

Konkretisht, projektet për bashkitë dhe ndryshimet përkatëse janë si më poshtë:

a) Pakësim fondi

Gr. 00 Tit. 06260 Kap. 05 Art. 230 6 000 000 lekë (Projekt preventiv zbatimi “Ndërtimi i Muzeut të Palafiteve dhe tharjes të kënetës të Maliqit”)

Shtesë fondi

Gr.00 Tit. 04130 Kap. 05 Art. 604 6 000 000 lekë (Kontribut për Bashkinë Maliq në lidhje me Projekt preventiv zbatimi “Ndërtimi i Muzeut të Palafiteve dhe tharjes të kënetës të Maliqit”)

Ky është një projekt i planifikuar që në vitin 2024, për të cilin Bashkia Maliq ka derdhur edhe kontributin e vet për llogari të Këshillit të Qarkut.

b) Pakësim fondi

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 05 Art. 231 1 200 000 lekë (Pajisje për qendrën infopoint Ersekë)

Shtesë fondi

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 05 Art. 604 1 200 000 lekë (Kontribut Bashkia Kolonjë për Pajisje për qendrën infopoint Ersekë)

Edhe ky projekt është i vitit 2024, por që Bashkia Kolonjë akoma nuk ka sjellë një preventiv në lidhje me pajisjet e kërkuara.

c) Pakësim fondi

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 01 Art. 231 14 722 118 lekë (Investime në bashkëpunim me bashkitë 60% me 40%)

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 05 Art. 231 8 000 000 lekë (Investime në bashkëpunim me bashkitë 60% me 40%)

Shtesë fondi

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 01 Art. 604 4 800 000 lekë (Kontribut Bashkia Pustec për blerje e një automjeti për pastrimin e liqenit dhe blerjen e një skafi 12 vendësh për transportin e turistëve.)

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 01 Art. 604 215 760 lekë (Kontribut Bashkia Maliq për sinjalistikën orientuese dhe markimin e shtegut në liqenet Lenie-Valamarë)

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 01 Art. 604 2 706 358 lekë (Kontribut Bashkia Devoll për zhvillimin e turizmit dhe ruajtjen e ekosistemit të Liqenit të Prespës të Vogël)

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 01 Art. 604 7 000 000 lekë (Kontribut Bashkia Pogradec me destinacion "Sistemim i rruges Rrëmenj-Gështenjas")

Gr. 00 Tit 04130 Kap. 05 Art. 604 8 000 000 lekë (Kontribut Bashkia Maliq me destinacion "Rivitalizimi Rrugë e Bacave Fshati Vlocisht")

Këto janë projekte që janë paraqitur me kërkesë nga ana e bashkive përkatëse, në vitin 2025 dhe do të financohen nga Këshilli i Qarkut në formën e kontributit me destinacion, për bashkitë, në raportin 60% (Qarku) me 40% (Bashkia).

Dy projektet e fundit, konkretisht të Bashkisë Pogradec dhe Bashkisë Maliq, janë 2 projekte të reja dhe mbështetja për to nuk do të jetë në këtë raport, por sipas fondeve të mbetura në dispozicion nga fondi që Qarku ka parashikuar për investimet në bashkëpunim me bashkitë.

Bazuar në sa u tha më sipër si dhe bazuar në Ligjin 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 29 i cili citon se: **Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të marrë dhe të japë transferta monetare ose ndihma me njësi të tjera të vetëqeverisjes vendore për ofrimin e të mirave dhe/ose shërbimeve, sipas marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet tyre**, Këshilli i Qarkut propozon këto ndryshime për të mos penguar realizimin e këtyre projekteve. Disbursimi i kontributeve do të bëhet pas dorëzimit nga ana e Bashkive të të gjithë dokumentacionit të kërkuar si dhe pas nënshkrimit të marrëveshjeve.

Korçë, më 02.09.2025

GMS

Erjon Nexhipi

Mimoza Shuli

Oljona Beqiraj

Marjona Bylykbasiri

Mariela Alicolli